

KONTRATË DHURIM KUOTE

Sot, më datë 02.02.2022 (dy mijë e njëzet e dy), u paraqitën personalisht palët e mëposhtme, të cilët ranë dakord me hartimin e kësaj Kontrate Dhurimi si më poshtë vijon:

1. Egi Santo, shtetas shqiptar, i biri i Artanit dhe i Arnajës, i lindur më 04.06.1988, në Tiranë, banues në adresën rruga Ismail Qemali, Pallati Credins, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit Nr. 024429559 dhe numër personal I80604062U.

quajtur këtu më poshtë "Dhuruesi",

2. Renis Haxhia, shtetas shqiptar, i biri i Maksimit dhe i Etlevës, i lindur më 14.07.1989, në Tiranë, banues në adresën Zibrak, rruga Kuvajt, Tiranë, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartën e identitetit Nr. 025325595 dhe numër personal I90714072M;

quajtur këtu me poshtë bashkërisht "Pranuesi i Dhurimit"

Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë vendosën redaktimin e kësaj Kontrate Dhurimi të kuotave me kusht mes tyre, sipas termave të mëposhtem:

MEQENËSE:

a) Dhuruesi është ortak dhe zotërues i një kuote, që i korrespondon 8% të kapitalit të shoqërisë "Max Energy" sh.p.k., regjistruar si person juridik me në qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT: L77003205H, me seli në Tiranë, Shqipëri;

b) Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë Pranuesit të Dhurimit 8% e kapitalit të Shoqërisë, me pëlqimin e Pranuesit të Dhurimit, i cili fiton pronësinë mbi këtë përqindje kapitali në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Kontratë;

NENI 1

BAZA LIGJORE DHE OBJEKTI

1.1. Kjo Kontrate bazohet në nenet 761 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenin 43 të Ligjit 9723/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

1.2. Objekt i kësaj Kontrate është kalimi në pronësi pa shpërblim i 8% të kapitalit të shoqërisë "Max Energy" shpk. Me anë të këtij dhurimi.



1.3. Pas nënshkrimit të Kontratës së Dhurimit të kuotave, Dhuruesi humbet pronësinë mbi kuotën dhe cilësinë e ortakut të shoqërisë dhe struktura e kuotave në kapitalin e shoqërisë **“Max Energy”** sh.p.k. do të jetë si më poshtë:

1. Z. Renis Haxhia, zotëron 1 (një) kuotë, në masën 56 % të kapitalit të shoqërisë **“Max Energy sh.p.k.”**;
2. Z. Arben Prifti zotëron 1 (një) kuotë, në masën 20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë **“Max Energy sh.p.k.”**;
3. Shoqëria Seman Sunpoëer sh.p.k zotëron 1 (një) kuotë, në masën 17 % të kapitalit themeltar të shoqërisë **“Max Energy sh.p.k.”**;
4. Z. Lavdosh Bala zotëron 1 (një) kuotë, në masën 7 % të kapitalit themeltar të shoqërisë **“Max Energy sh.p.k.”**.

NENI 2 KUSHTE DHE AFATE

- 2.1.** Dhuruesi i dhuron pa asnjë kusht dhe pa kundër shpërblim Pranuesit të Dhurimit, përqindjen e kapitalit të përshkruar në nenin 1, pika 1.2 të kësaj Kontrate.
- 2.2.** Pranuesi i Dhurimit pranon dhurimin duke njohur dhe pranuar gjendjen juridike dhe financiare të Shoqërisë pa asnjë rezervë të çfarëdolloji.
- 2.3.** Dhuruesi pranon të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim që t'i transferojë Pranuesit të Dhurimit përqindjen e kapitalit në zbatim të kësaj Kontrate.

NENI 3 EFEKTET E KONTRATËS



- 3.1.** Kjo Kontratë lidhet sipas nenit 73 të ligjit nr. Nr.9901, datë 14.4.2008 **“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”**.

NENI 4 TRANSFERIMI I KUOTES

- 4.1.** Kjo Kontratë hyn në fuqi dhe transferimi i pronësisë mbi Kuotën sipas kësaj Kontrate do të realizohet me nënshkrimin e kësaj Kontrate
- 4.2.** Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit do të nënshkruajnë dhe dorëzojnë çdo instrument të nevojshëm për transferimin e Kuotës dhe regjistrimin e këtij transferimi në regjistrat e Shoqërisë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose në çdo autoritet apo institucion tjetër sipas ligjeve shqiptare.

NENI 5 DEKLARATA DHE GARANCI

- 5.1.** Dhuruesi i deklaron dhe garanton Pranuesin e Dhurimit se:
 - a.** Kuota është e lirë nga çdo lloj pengu, detyrimi. Dhuruesi ka të drejtë të dhurojë dhe transferojë Kuotën sipas kësaj Kontrate.



- b. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat apo dokumentet e tjera ligjore ne te cilat Dhuruesi është pale.
- c. Dhuruesi deklaron dhe garanton Pranuesit e Dhurimit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë te vërteta, te sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

5.2. Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe garanton Dhuruesin se:

- a. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesit e Dhurimit, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat apo dokumentet e tjera ligjore ne te cilat Përfituesi është pale.
- b. Pranuesit e Dhurimit deklarojnë dhe garantojnë Dhuruesin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë të vërteta, të sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime në datën e nënshkrimit.

Neni 6

DISPOZITA TE FUNDIT

- 6.1. Kjo Kontratë përmban marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me goje apo me shkrim, duke përjashtuar ne këtë mënyrë çdo pretendim për detyrime te mëtejshme ndërmjet Palëve.
- 6.2. Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera të mëparshme dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër të mëparshëm.
- 6.3. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- 6.4. Çdo konflikt në lidhje me nënshkrimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë u nënshkrua rregullisht nga Palët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

PALËT

DHURUESI

EGI SANTO

Egi SANTO



PËRFITUESI

Renis Haxhia

Renis HAXHIA